




Pranimi / Dorezuar Prilbjen / Pridato Received / Delivery	10. 05 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHICK	2682/2022		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.339/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.339/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në

kundër Vendimit Nr.13-112/12-0018979/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.339/2022 e datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Anullohet Vendimi Nr.13-112/12-0018979/22 i datës 14.03.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës si dhe procedura e rekrutimit me numër reference RN00007792 për pozitën e punës Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/Zyrtar i Trashëgimisë.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Podujevës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 06.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1910/2022, e regjistruar me shenjë A.nr.339/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës kundër Vendimit Nr.13-112/12-0018979/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa kjo fundit më datë 19.04.2022, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokollit 1910/2022 të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e kandidatëve të aprovuar përmes Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 24.12.2021 me Nr. 286/2021; Vendimin Nr.13-112/12-0018979/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Podujevës; Letër rekomandim e datës 16.11.2018, 17.09.2019 për ankuesin; Vërtetimet nga Sekretariatit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i viti 2021 për ankuesin; Referencë me Nr. 1345 e datës 17.09.2019 nga Komuna e Fushë Kosovës për ankuesin; Diplomën me nr.4770 e datës 02.09.2016 në emër të ankuesit; Certifikatën 09-10.11.2020 për ankuesin; Ankesën e ankuesit e parashtruar në Komunën e Podujevës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës me numër protokollit 2201/2022 të datës 19.04.2022, Konkursin me Nr. Reference RN00007792 të datës 01.11.2021 për pozitën emri i grupit *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturor* respektivisht "Zyrtar për Trashëgimi", Vendimin me Nr.02-020/04-0010235/22 i datës 10.02.2022 për themelimin të Komisionit për Vlerësimin për Pranim dhe Zhvillim të Procedurave; Listën e Aplikantëve; Vendimin me Nr. 269/2021 i datës 24 dhjetor 2021 për refuzim të ankesës për listë të shkurtër; Vendimin me Nr. 267/2021 i datës 24 dhjetor 2021 për aprovimin e ankesës së kandidatit kundër listës së shkurtër; Ankesë kundër vendimit për mosplotësimin e kushteve për aplikim e datës 22.12.2021; Vendimin me Nr. 265/2021 i datës 24 dhjetor 2021 për refuzimin e ankesës së kandidatit kundër listës së shkurtër; Njoftimin me Nr. 13-37/2022 i datës 25.02.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për mbajtjen e testimit elektronik; Njoftimin me Nr. 13-51/2022 i datës 02.03.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për mbajtjen e intervistës me gojë; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Shkresë për kumtimin e rezultateve të vlerësimit e datës 07.03.2022 për kandidatin e suksesshëm; Aplikacionin e ankuesit data e aplikimit 01.12.2021; Letër njoftimin; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë e datës 27.07.2021; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesë të lartë-Gjimnazit e datës 19.09.2011; Shkresë e datës 13.06.2012 nga Erasmus Mundus; Aplikacionin e kandidatit data e aplikimit 06.12.2021; Diplomën me nr.2354 e datës 01.06.2017, Certifikatën me Nr.08-02/02 e datës 21.07.2020, Letër Referencë e datës 30.03.2018, Letër rekomandim e datës 31.10.202, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë e datës 30.11.2021; Aplikacionin e kandidatit e datës 01.12.2021; Vërtetimin Ref.nr.795/07 i datës 22.02.2021, Certifikatën e datës 27.09.2013, Certifikatë 08-10.07.2014, Certifikatën 20-21.11.2017, Rekomandimin e datës 07.12.2016 na Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Autorizim nga IndexKosova, Vërtetimin e datës 15.07.2019, Marrëveshjen për ofrim të shërbimeve të veçanta e datës 27.09.2017, Letër Rekomandim i datës 19.06.2018, Shkresë e datës 26.10.2019, Letër reference nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti Filozofik; Referencën e datës 19.11.2021; Certifikatën e

lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë e datës 24.11.2021, Diplomën me nr.3924 e datës 14.04.2015; Aplikacionin e kandidatit e datës 02.12.2021: Diplomë nga The Cambridge School e datës 26.07.2007, Diplomë nga KINGS e datës 31.05.2000, Diplomë e datës 01.09.2006, Vërtetim nga GEOKOS e datës 16.10.2017, Shkresë nga M-technologie e datës 26.09.2019, Vërtetimin me Nr. 109/2021 e datës 09.10.2021, Vendimin me Nr.575/2021 i datës 01.12.2021, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë e datës 30.11.2021, Diplomën me nr. 1378 e datës 28.04.2009.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtoi dhe analizoi me kujdes provat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Komuna e Podujevës, më datë 01.11.2021 ka shpallur Konkursin e hapur me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë, klasa profesional 2*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 22.11.2021 deri me 06.12.2021. Në këtë konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin. Në listën e ngushtë të datës 14.12.2021 janë përfshirë katër(4) kandidatë, në kuadër të cilës është edhe ankuesi i cili ka qenë edhe pjesë e të gjitha fazave tjera të konkurrimit, respektivisht në testimin me shkrim i mbajtur më datë 01.03.2022 dhe intervistën me gojë e mbajtur më datë 04.03.2022. Sipas Listës përfundimtare të Komisionit të Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr.02-020/04-0010235/22 të datës 11.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevas, kandidati me i vlerësuar duke u renditur i pari në listë është me gjithsej 80.6 pikë, ndërsa ankuesi është vlerësuar si kandidati i dytë me gjithsej 51.04 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës, më datë 07.03.2022 ka bërë publikimin e njoftimin për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin e datës 07.03.2022, parashtron ankesë më datë 08.03.2022 pranë Komisionit të Pranimit i cili me Vendimin Nr.13-112/12-0018979/22 të datë 14.03.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 07.03.2022.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar Vendimin Nr.13-112/12-0018979/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit, me pretendimet ankimore se ka pas shkelje ligjore lidhur me procedurën rekrutuese për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/Zyrtar i Trashëgimisë*, që nga faza e verifikimit të aplikacioneve e deri të shpallja e rezultatit përfundimtar. Me tej shton se rezultatet e grumbulluara nga intervista nuk janë komunikuar në asnjë formë; Në rezume jam vlerësuar me vetëm 10.4 pikë nga 20 të mundshme edhe pse kam përgatitje profesionale adekuate, përvojë të punës profesionale dhe certifikata për trajnime të caktuara; Kandidati i shpallur i suksesshëm nuk ka shkollim për t'u përfshirë në listën e ngushtë sepse ai posedon diplomë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Drejtimi Gjeografi, si rezultat drejtimi i këtij kandidati nuk është relevant me atë që është kërkuar në konkurs.

Sipas Konkursit me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist përgjithshëm i trashëgimisë kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë*, si kushte formale janë kërkuar: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Drejtimet Histori, Arkeologji, Etnologji apo të ngjashme, Përvoja e punës së kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë".*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se rezultatet e grumbulluara nga intervista nuk janë komunikuar për kandidatët, organi i punësimit në përgjigjen në ankesë deklaroi se njoftimi i kandidatëve bëhet përmes sistemit elektronik SIMBNJ, mirëpo nga shkresat e lëndës Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi që kandidatët respektivisht ankuesi të jetë njoftuar me shkrim lidhur me rezultatit e testit me shkrim, intervistës me gojë dhe rezultatit e jetëshkrimit, e si rrjedhojë Kolegji vlerëson se njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 25 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: *Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatit e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit*", kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore, për pozitën e punës *Specialist i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë*, e renditur me kodin 20 fusha e arsimit të kërkuar është fakulteti i *Historisë dhe Arkeologjisë* ndërsa sipas Konkursit me numër referencë RN00007792, si fushë e arsimit është përcaktuar *Drejtimit Histori, Arkeologji, Etnologji apo të ngjashme*, e që sipas vlerësimit të Kolegjit organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pasi që kriteret e përcaktuara me konkurs nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.

Përkritazi me pretendimin e ankuesit se kandidati i përzgjedhur fitues nuk ka shkollimin e kërkuar sipas konkursit pasi që i njëjti posedon diplomë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Drejtimi Gjeografi, Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatit fitues ka konstatuar se i njëjti sipas Diplomës me nr.2354 të datës 01.06.2017 ka përfunduar studimet themelore me datë 26.04.2017 duke marrë titullin Bachelor i Gjeografisë Aplikative dhe rrjedhimisht Kolegji konstaton se i njëjti bazuar në kërkesat e përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nuk ka plotësuar kriterin e fushës së arsimit për pozitën e shpallur.

Po ashtu duke ju referuar kriterëve të përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës lidhur me pozitën e punës *Specialist i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë*, Kolegji bazuar në provat material gjen se edhe dy kandidatët tjerë të përfshirë në listën e ngushtë nuk kanë përmbushur kriterin lidhur me fushën e arsimit, respektivisht ankuesi sipas Diplomës me nr.4779 të datës 02.09.2016 ka përfunduar studimet në Fakultetin Filologjik Departamenti i Etnologjisë dhe ka marrë titullin Bachelor i Etnologjisë, ndërsa kandidatja sipas Diplomën me nr.3924 të datës 14.04.2015 ka përfunduar studimet në Fakultetin Filologjik Departamenti i Etnologjisë dhe ka marrë titullin Bachelor i Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore.

Lidhur me kriterin formal të përvojës së punës "*Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë*", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa konstaton se përvoja e punës për pozitën në fjalë duhet të jetë në fushën që zhvillohet

procedura rekrutuese, ndërsa në bazë të vlerësimit të provave të lëndës të dy kandidateve të përfshirë në listën e shkurtër dhe që kanë vazhduar konkurimin, Kolegji ka gjetur që kandidati i përzgjedhur/fitues si dhe kandidatja nuk kanë plotësuar as kriterin e përvojës së punës, kështu që mbi këto arsye rrjedhë se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës me përfshirjen në listën e shkurtër të kandidatëve të lartcekur që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë..* ndërsa Komisioni i Pranimit nuk ka respektuar dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është theksuar se: *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, ... bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.*

Po ashtu, Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se me Vendimin me Nr.02-020/04-0010235/22 të datës 11.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevë për themelimin e Komisionit të Pranimit nuk janë përcaktuar edhe zëvendësuesit e anëtarëve të Komisionit të Pranimit ashtu siç përcaktohet me neni 18 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 17 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, e meqenëse janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1. 3 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedure e paligjshme, kështu që Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.339/2022

Avdyl BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunes së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

